

STATUTI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË GRUAS SË SHQIPËRISË



TIRANË, 22 QERSHOR 2002

Pasqyra e lëndës

Të përgjithshme.....	4
Lidhja Demokratike e Gruas së Shqipërisë	4
Qëllimi i LDGSH.....	4
Partneriteti politik	4
Qendra e LDGSH dhe degët e saj.....	4
Simboli dhe vula	4
Politikat gjinore.....	5
Veprimtaria publike	5
Anëtarësimi në LDGSH.....	7
Anëtarësia.....	7
Procedura e pranimit.....	7
Të drejtat e anëtarëve	7
Detyrat e anëtareve.....	7
Përfundimi i anëtarësisë.....	8
Largimi	8
Masa disiplinore	8
Shkaqe të tjera të përjashtimit.....	8
Organizimi dhe funksionimi i LDGSH	10
Organizimi dhe funksionimi lokal	10
Organet lokale të LDGSH	10
Seksioni.....	10
Mbledhja e anëtarëve të seksionit	10
Dega e LDGSH	11
Kuvendi i degës.....	11
E drejta e kërkesave dhe e propozimeve	11
Propozimet e kandidaturave për organet e PDSH.....	11

Përputhshmëria e vendimeve dhe akteve të tjera.....	12
Raportimi	12
E drejta e informimit	12
E drejta e ndërhyrjes	12
Organizimi dhe funksionimi qendror.....	13
Organet qendrore të LDGSH.....	13
Kuvendi Kombëtar i LDGSH	13
Thirrja e Kuvendit Kombëtar	13
Kompetencat e Kuvendit Kombëtar	13
Këshilli Kombëtar.....	14
Kryesia Qendrore.....	14
Kryetarja e LDGSH.....	15
Sekretarja e Përgjithshme	15
Përcaktime të tjera	17
Aftësia vendimmarrëse	17
(Kuorimi).....	17
Shumicat e kërkuara për të marrë vendime.....	17
Llojet e votimit.....	17
Dokumentimi i vendimeve	17
Veprimtaria ekonomike dhe financiare e LDGSH	18
Dispozita të fundit	18
Hyrja në fuqi	18

Të përgjithshme

Neni 1

Lidhja Demokratike e Gruas së Shqipërisë

Lidhja Demokratike e Gruas së Shqipërisë (LDGSH) është një organizim vullnetar i grave shqiptare të bashkuara mbi bazën e parimeve dhe të vlerave të liberaldemokracisë në Shqipëri. LDGSH është një organizatë partnere e Partisë Demokratike të Shqipërisë (PDSH).

Neni 2

Qëllimi i LDGSH

LDGSH ka si qëllim të veprimtarisë së saj promovimin dhe përhapjen e vlerave e të parimeve të botëkuptimit liberaldemokrat, pasqyrimin dhe propagandimin e tyre të shprehura në platformat dhe programet e PDSH, edukimin dhe rrënjosjen në shoqërinë shqiptare të vlerave themelore të një shoqërinë shqiptare të vlerave themelore të një shoqërie të bazuar mbi mbrojtjen e gruas dhe nga dhunimi e degradimi moral, si dhe evindetimin dhe propagandimin e vlerave tradicionale morale të familjes dhe gruas shqiptare. LDGSH synon me veprimtarinë e saj të zhvillojë të drejtat e individit në tërësi dhe të gruas në veçanti. Eliminimi i diskriminimit gjinor është objektiv parësor i LDGSH.

Neni 3

Partneriteti politik

LDGSH për të arritur qëllimet e saj vepron në rrugë demokratike në përputhje me programin e saj, si dhe programin e vijën politike të PDSH.

LDGSH përfaqëson interesat politike të anëtarësisë së vet, kujdeset për zbatimin e politikave të PDSH, në kuadër të bashkëpunimit partnerial, promovon pjesëmarrjen e grave demokrate në strukturat politikëbërëse dhe vendimmarrëse të PDSH, si dhe angazhimin e tyre në funksione politike.

Neni 4

Qendra e LDGSH dhe degët e saj

Qendra e LDGSH ndodhet në Tiranë në adresën rruga “Punëtorët e Rilindjes” Nr. 1. LDGSH ka të drejtë të krijojë degë të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Degët krijohen (shpërndahen) me vendim të Këshillit Kombëtar të LDGSH.

Neni 5

Simboli dhe vula

LDGSH ka simbolin dhe vulën e saj, si dhe të drejtën e hapjes së llogarive bankare në përputhje me përcaktimet ligjore. (vula)



Neni 6

Politikat gjinore

LDGSH kujdeset në mënyrë të veçantë:

- për rritjen e rolit të gruas për ndërtimin e një shoqërie demokratike,
- për promovimin e ideve bazë të LDGSH për politikat gjinore tek vajzat dhe grate;
- për përfaqshmin dhe mbrojtjen e interesave të tyre në politikën e PDSH;
- për kundërvënien ndaj çdo diskriminimi për shkak të përkatësisë gjinore;
- për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të grave dhe të fëmijëve brenda familjes dhe në shoqëri.

Neni 7

Veprimtaria publike

LDGSH për realizimin e qëllimeve të veta:

- Zhvillon fushata, veprimtari promovuese dhe sensibilizuese në shërbim të politikave të programeve të saj;
- Bashkëpunon në partneritet me strukturat e PDSH, si dhe përfaqësuesit e zgjedhur të saj për përfshirjen e specifikave dhe interesave të femrës në politikat dhe veprimtarinë ligjvënëse të strukturave të PDSH;
- Bashkëpunon me gratë parlamentare dhe me gratë e zgjedhurave të strukturave të tjera për promovimin dhe garantimin e shanseve të barabartave për pjesëmarrje në politike
- Bashkëpunon me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit me të cilat në emër të dinjitetit dhe rolit të gruas në shoqëri zhvillon programe dhe projekte të përbashkëta;
- Konsideron të një rëndësie të veçantë bashkëpunimin me organizatat e ngjashme shoqërore dhe në trojet e banuar me shqiptarë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe diasporë, në mbrojtje të vlerave të qenësishme të gruas dhe të familjes shqiptare.

Anëtarësimi në LDGSH

Neni 8

Anëtarësia

Anëtare e LDGSH mund të jetë çdo vajzë apo grua që ka mbushur moshën 18 vjec, që pranon programin dhe statutin e saj, pa dallim nga gjendja shoqërore, kombësia apo raca.

Anëtarët e LDGSH mund të jenë simpatizante ose anëtare të PDSH. Nuk mund të jenë anëtare të LDGSH anëtarët e partive ose organizatave partnere të partive në kundërshti politike me PDSH, sikurse edhe anëtarët e forumeve drejtuese të partive të tjera.

Anëtarët e LDGSH duhet të gëzojnë një figurë të pastër shoqërore dhe morale.

Në LDGSH nuk mund të pranohen gra të frymëzuara nga ide jodemokratike dhe që propagandojnë ide të totalitarizmit, racizmit, diskriminimit gjinor, si dhe gra që kanë shërbyer në Sigurimin e Shtetit apo kanë marrë pjesë në nomenklaturën komuniste.

Neni 9

Procedura e pranimit

Për t'u pranuar anëtare e LDGSH paraqitet një kërkesë e argumentuar dhe plotësohet formulari përkatës, ku deklarohet se pranohet Statuti dhe Programi i LDGSH dhe ky formula paraqitet në secilën nga strukturat në të cilat ajo është e angazhuar. Miratimi i kërkesës bëhet në kolegjalitet me titullaret e degës (kryetare, nënkryetare, sekretare). Në rast refuzimi të kërkesës nga seksioni, personi mund të ankohet në kryesinë e degës së LDGSH e më pas në kryesinë qendrore, e cila vendos përfundimisht për këtë çështje.

Neni 10

Të drejtat e anëtarëve

Çdo anëtare ka këto të drejta:

Të marrë pjesë dhe të shprehë lirisht mendimin e saj në mbledhjet e strukturave ku bën pjesë.

Të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjithë organet e lidhjes në përputhje me procedurat që parashikon ky statut.

Të informohet për veprimtarinë e LDGSH dhe me vendimet e marra.

Të marra pjesë në të gjitha mbledhjet që kanë lidhje të drejtpërdrejt me personin e saj.

Të drejtohet për çështjet vetjake dhe të lidhjes në të gjitha nivelet të organve drejtues të LDGSH.

Neni 11

Detyrat e anëtarëve

Anëtarët kanë për detyrë:

Të zbatohet dhe të respektohet me seriozitet dhe disiplinë maksimale statutin, vendimet, urdhëresat që rregullojnë jetën e brendshme të strukturave të LDGSH si dhe të punojë për përmbushjen e qëllimeve të programit të saj.

Të ruajë të pastër figurën e saj morale për të mos dëmtuar autoritetin e LDGSH.

Të paguajë rregullisht kuotën e anëtarësisë në LDGSH, sipas një shume të përcaktuar nga kryesia e LDGSH.

Neni 12

Përfundimi i anëtarësisë

Anëtarësia përfundon kur anëtarja vdes, largohet apo përjashtohet. Organi përkatës që në bazë të këtij statuti miraton anëtarësimin ka të drejtë që me vendim të shumicës së anëtarëve të shfuqizojë një vendim pranimit nëse anëtarja përkatëse me kërkesën e saj ka paraqitur të dhëna të rreme ose ka fshehur fakte të rëndësishme që kanë të bëjnë me pranimin, të parashikuara nga ky statut. Anëtarja ka të drejtë të ankohet sikurse është përcaktuar në nenin 9 të këtij statuti.

Neni 13

Largimi

Çdo anëtare mund të largohet nga lidhja me vullnetin e saj, duke njoftuar me shkrim seksionin ku bën pjesë. Në këtë rast bëhet çregjistrimi dhe dorëzohet librezja e anëtarësisë.

Neni 14

Masa disiplinore

1. Kryesitë përkatëse mund të vendosin masa disiplinore kundrejt anëtarëve të tyre nëse ato kryejnë veprime që bien në kundërshtim me statutin apo parimet themelore të LDGSH.
2. Masa disiplinore janë:
 - a. Vërejtje,
 - b. Qortim,
 - c. Heqje funksionesh, nëse ka,
 - d. Heqje me afat kohore e së drejtës për të mbajtur funksione në LDGSH
 - e. Pezullimi i përkohshëm në LDGSH.
3. Në rastet kur subjekti i këtij neni është anëtare e degës, vendos kryesia e degës dhe miraton (ose refuzon) kryesia qendrore; kur subjekti i tyre është anëtarja e Kryesisë Qendrore ose Këshillit Kombëtar, vendos Kryesia Qendrore dhe më pas miraton (refuzon) Këshilli Kombëtar i LDGSH.

Për rastet e tjera e merr vendimin organi që ka bërë pranimin.

Neni 15

Shkaqe të tjera të përjashtimit

Në rast se ka konsumuar një vepër të rëndë penale të parashikuar nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Organizimi dhe funksionimi i LDGSH

Organizimi dhe funksionimi lokal

Neni 16

Organet lokale të LDGSH

Organet dhe strukturat e LDGSH janë:

1. Seksioni,
2. Nëndega,
3. Dega,
4. Kryesia e degës ose nën degës,
5. Aktivi i degës ose nëndegës,
6. Kuvendi i degës ose nëndegës.

Neni 17

Seksioni

1. Seksioni është njësi bazë e LDGSH. Ai organizohet në bazë territori lagjeje, komune, sipas organizimit të PDSH dhe vendimit të kryesisë së degës. Si rregull, numri i anëtarëve të seksioni lëviz nga 7-30 veta.
2. Krijimi, shkrirja, bashkimi ose ndarja e seksioneve është në kompetencë të kryesisë së degës përkatëse.
3. Seksioni drejtohet nga kryesia e tij e përbërë nga 3-5 anëtare, në varësi nga numri i anëtarëve të seksionit. Kryesia e seksionit përbëhet nga kryetarja, sekretarja dhe anëtarët e kryesisë.
4. Kryesia zgjidhet çdo tre vjet me votim të fshehtë nga mbledhja e anëtarëve të seksionit. Numri i anëtarëve që i nënshtrohet votimit duhet të jetë të paktën dy herë më i madh se numri i vendeve në kryesi.
5. Kryetarja zgjidhet me votim të fshehtë, me jo më pak se dy kandidatura, nga mbledhja e anëtarëve të seksionit. Kryetarja nuk mund të zgjidhet më shumë se dy herë radhazi.
6. Sekretarja e seksionit emërohet nga kryesia e degës ndërmjet kandidaturave të propozuara nga seksioni.

Neni 18

Mbledhja e anëtarëve të seksionit

Mbledhja e seksionit mbledhet nga kryetarja, kryesia ose 1/3 e anëtarëve të seksionit. Mbledhja thirret sipas nevojave por jo më rrallë se një herë në muaj. Vendimet e mbledhjes së seksionit konsiderohen të vlefshme mbi gjysmat e anëtarëve të tij. Nëse për të njëjtën çështje seksioni

thërritet për herë të dytë, për shkak të mosplotësimit të kuoromit atëherë mbledhja e dytë ka aftësi vendimmarrëse pavarësisht nga kuorumi. Në këtë rast njoftimi me shkrim për datën dhe rendin e ditës është i detyrueshëm.

Neni 19

Dega e LDGSH

1. Degët e LDGSH formohen me vendim të Këshillit Kombëtar në bazë rrethi dhe përbëhen nga seksione të aty ndodhura.
2. Në periudhën mes konferencave dhe aktiveve, dega drejtohet nga kryesia e degës.
3. Aktiviteti i degës/nëndegës thirret nga kryesia e degës/nëndegës e cila njofton paraprakisht kryesinë e LDGSH për datën dhe rendin e ditës. Rendi i ditës dhe data e mbledhjes njoftohen jo më vonë se dy ditë përpara aktivitetit.

Neni 24

Kuvendi i degës

1. Kuvendi i degës është organi më i lartë i degës së LDGSH. Ai përbëhet nga aktiviteti i degës dhe delegatet e zgjedhura për një mandat 3 vjeçar në seksionet përkatëse, sipas një raporti të përcaktuar nga Këshilli Kombëtar i LDGSH.
2. Kuvendin e degës e thërret kryesia e degës në marrëveshje me Kryesinë e LDGSH. Ai mund të thirret kur e kërkon edhe 1/4 e delegateve të kuvendit të degës, si dhe me kërkesë të Kryesisë së LDGSH. Në këto raste caktimi i datës dhe i rendit të ditës duhet të bëhet jo më vonë se dy ditë nga marrja e kërkesës. Njoftimi i datës dhe rendit të ditës në çdo rast duhet të bëhet 5 ditë përpara.
3. Kuvendi i degës së LDGSH zgjedh kryesinë, kryetaren e degës dhe anëtarët e Kuvendit Kombëtar të LDGSH. Ai vendos për çështje të rëndësishme të LDGSH.

Neni 25

E drejta e kërkesave dhe e propozimeve

Të drejtën e nismave, nismës vendimmarrëse kërkesave dhe propozimeve për kuvendin e degës e kanë:

1. Kryesia e LDGSH,
2. Kryesia e degës ose e nëndegës,
3. Kryetarja e degës ose e nëndegës,
4. Kryesia e seksionit,
5. 10% e anëtareve të kuvendit të degës më të drejtë vote.

Kërkesat u nështrohen diskutimit dhe votimit kur janë të nënshkruara prej paraqitësve dhe kur janë depozituar pranë sekretarisë përpara fillimit të seancës përkatëse.

Neni 26

Propozimet e kandidaturave për organet e PDSH

Paraqitja e propozimeve për kandidatura për organet lokale të PDSH dhe pushtetin lokal të saj bëhet nga kryesia e degës në marrëveshje me Kryesinë Qendrore të LDGSH, ndërsa për organet qendrore të PDSH e të pushtetit qendror nga Kryesia e LDGSH. Kryesia e LDGSH duhet të informohet për cdo hap të procesit të daljes së kandidaturave të cilat mbështeten në organet vendimmarrëse të PDSH.

Neni 27

Përputhshmëria e vendimeve dhe akteve të tjera

Të gjitha vendimet e marra në nivel dege e seksioni duhet të jenë në përputhje me statutin dhe programin e LDGSH, si dhe të mos bien në kundërshtim me linjat politike të përcaktuara nga organet qendrore të saj.

Neni 28

Raportimi

Në mënyrë periodike seksionet i raportojnë degës veprimtarinë e tyre politike, ndërsa degët kryesisë qendrore të LDGSH.

Neni 29

E drejta e informimit

Kryesia qendrore ka të drejtë t'u kërkojë degëve dhe seksioneve cdo informacion lidhur me aktivitetin e tyre politik, kur ky i fundit konsiderohet i nevojshëm. Këtë të drejtë e ka edhe dega ndaj seksioneve.

Neni 30

E drejta e ndërhyrjes

Në rast se kryetarja dhe/ose kryesia e degës thyejnë rëndë ose në mënyrë të përsëritur statutin, rregulloret apo udhëzimet, Kryesia e LDGSH ka të drejtën e ndërhyrjes dhe në raste të veçanta të pezullimit të tyre e të caktimit të një drejtuesi të komanduar deri në mbledhjen e kuvendit të degës, të cilin duhet ta organizojë brenda afateve minimale të mundshme.

Këtë të drejtë e ka edhe kryesia e degës ndaj seksionit.

Organizimi dhe funksionimi qendror

Neni 31

Organet qendrore të LDGSH

Organet qendrore të LDGSH janë:

1. Kuvendi Kombëtar i LDGSH,
2. Këshilli Kombëtar i LDGSH,
3. Kryesia Qendrore e LDGSH.

Neni 32

Kuvendi Kombëtar i LDGSH

1. Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë i LDGSH.

Si rregull, Kuvendi Kombëtar thirret një herë në cdo tre vjet. Gjithashtu Kuvendi Kombëtar mund të mbledhet edhe në raste të posaçme.

2. Kuvendi Kombëtar përbëhet nga:

- a. anëtare të zgjedhura nga kuvendet e degëve në përputhje me numrin e përcaktuar nga Këshilli Kombëtar i LDGSH, sipas një raporti të njëjtë përfaqsimi;
- b. anëtarët e Këshillit Kombëtar të LDGSH;
- c. anëtarët e Këshillit Kombëtar dhe deputetët e PDSH.

Në punimet e Kuvendit Kombëtar mund të marrin pjesë edhe personalitete të ftuara nga brenda dhe jashtë vendit.

Neni 33

Thirrja e Kuvendit Kombëtar

1. Vendimin për thirrjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar me propozim të Kryesisë Qendrore ose të 1/4 të anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Data e zhvillimit të kuvendit dhe rendi i ditës njoftohen të paktën 30 ditë përpara fillimit të saj.

2. Kuvendi Kombëtar mund të mbledhet edhe në raste të posaçme. Kuvendi i Posacëm thirret me kërkesën e Këshillit Kombëtar ose me 1/4 e delegateve të kuvendit. Në këtë rast Kryesia e LDGSH njofton brenda dy javësh rendin e ditës dhe datën e kuvendit.

Neni 34

Kompetencat e Kuvendit Kombëtar

Kuvendi Kombëtar i LDGSH përcakton drejtimin politik të LDGSH.

Kuvendi Kombëtar miraton ndryshimet e statutit dhe të programit të LDGSH.

Kuvendi Kombëtar zgjedh kryetaren e LDGSH nga jo më pak se dy kandidaturre.

Kuvendi Kombëtar zgjedh anëtarët e Këshillit Kombëtar të LDGSH.

Neni 35

Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar i LDGSH drejton veprimtarinë e lidhjes në periudhën nëpërmjet dy kuvendeve. Ai merr të gjitha vendimet që kërkojnë rrethanat, me përjashtim të atyre që janë kompetencë ekskluzive e Kuvendit Kombëtar sipas përcaktimeve të këtij statuti.

1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga:

- a. Kryetarja e LDGSH,
- b. Sekretarja e përgjithshme e LDGSH,
- c. Nënkryetarët e LDGSH,
- d. Kryetarët e degëve të LDGSH,
- e. Anëtarët e Këshillit Kombëtar dhe deputetët e PDSH,
- f. Anëtare të zgjedhura sipas nenit 37 të këtij statuti.

Numri i tyre përcaktohet nga Kryesia e LDGSH e cila merr parasysh faktin që numri anëtarëve të dala sipas pikave “e” dhe “f” të këtij neni të jetë dy herë më i madh se numri i anëtarëve të pikave të tjera.

Numri i kandidateve duhet të jetë jo më pak se 1.5 herë më i madh se numri i kërkuar. Anëtarët e Këshillit Kombëtar propozohen nga kryesitë e degëve, Kryesia e LDGSH, si dhe nga jo më pak se 10% e delegateve të Kuvendit Kombëtar. Lista përfundimtare dhe numri i kandidatura miratohet në Kryesinë e LDGSH

2. Këshilli Kombëtar mbledhet së paku tri herë në vit. Mbledhja e Këshillit Kombëtar thirret nga kryesia ose 1/3 e anëtarëve të saj. Rendi i ditës i Këshillit Kombëtar lajmërohet së paku tri ditë para zhvillimit të mbledhjes.

3. Kompetencat:

- a. Këshilli Kombëtar zgjedh Kryesinë e LDGSH që përbëhet prej 25 anëtarësh. Numri i kandidaturave të paraqitura duhet të jetë jo më pak 1.5 herë më shumë se numri i vendeve në kryesi.
- b. Këshilli Kombëtar zgjedh sekretaren e përgjithshme dhe nënkryetarët të LDGSH, numri i të cilave përcaktohet prej tij dhe që mbulojnë çështje të veçanta të LDGSH.
- c. Këshilli Kombëtar me propozim të Kryesisë Qendrore miraton anëtarësinë e LDGSH ose të strukturave të veçanta të saj në organizime kombëtare e ndërkombëtare.
- d. Këshilli i Kombëtar mbi bazën e propozimeve të kryesive të degëve dhe kryesisë qendrore të LDGSH vendos për propozimet që do t'i paraqesë organeve qendrore të LDGSH.

Neni 36

Kryesia Qendrore

1. Kryesia Qendrore e LDGSH drejton në periudhën midis dy mbledhjeve të Këshillit Kombëtar, si dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të tij. Ajo ka të drejtë të marrë të gjitha vendimet e nevojshme për çështjet, me përjashtim të atyre që sipas këtij statuti janë kompetencë e organeve të tjera qendrore.
2. Kryesia Qendrore përbëhet nga:
 - a. Anëtare të zgjedhura sipas pikës 3/a të nenit 38 të statutit,
 - b. Kryetarja, Sekretarja e Përgjithshme dhe nënkryetarët e LDGSH;
 - c. Kryetarët e degëve të kategorisë së parë të LDGSH (sipas përcaktimit të bërë për degët e PD).
3. Mbledhja e kryesisë thirret dhe drejtohet nga kryetarja e LDGSH, si dhe nga sekretarja e përgjithshme me autorizim nga kryetarja.

Mbledhja e kryesisë thirret edhe nga 1/4 e anëtareve të saj dhe në këtë rast mbledhja zhvillohet jo më vonë se pesë ditë nga data e depozimitit të kërkesës. Në cdo rast anëtarët e kryesisë njoftohen jo më vonë se dy ditë para zhvillimit të mbledhjes, duke u paraqitur anëtareve edhe materialet me shkrim kur është rasti.

Kryesia vendos për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Kombëtar.

Neni 37

Kryetarja e LDGSH

1. Kryetarja e LDGSH përfaqson Lidhjen Demokratike të Gruas së Shqipërisë. Ajo konfirmon dhe drejton mbledhjet e Kuvendit Kombëtar, të Këshillit Kombëtar, të Kryesisë Qendrore, si dhe udhëheq të gjitha veprimtaritë brenda dhe jashtë vendit që këto organe i besojnë asaj.
2. Në mungesë të saj ose me delegim prej saj Lidhjen Demokratike të Gruas Shqiptare e përfaqson njëra nga nënkryetarët ose sekretarja e përgjithshme.
3. Kryetarja dhe Kryesia e LDGSH ka një mandat trevjeçar me të drejtë rikandidimi dhe rizgjedhjeje për një mandat të dytë.
4. për punën e saj kryetarja e LDGSH jep llogari para Kuvendit Kombëtar të LDGSH.

Ajo largohet:

- a. me mbarimin e mandatit,
- b. me dorëheqje vullnetare,
- c. me vendim mazhoritar të Kuvendit Kombëtar të LDGSH në një sesion të jashtzakonshëm.

Neni 38

Sekretarja e Përgjithshme

1. Sekretarja e Përgjithshme zgjidhet cdo tre vjet në përputhje me nenin 35, pika 3/b të statutit.
2. Sekretarja e Përgjithshme:
 - a. Ndhmon kryetaren në përmbushjen e detyrave të saj;

- b. Merr masa për publikimin dhe zbatimin e vendimeve të LDGSH;
- c. Drejton funksionimin administrativ dhe organizativ të LDGSH;
- d. Për kompetencat që i jep ky statut, si dhe kur ia ngarkon kryetarja, përfaqson ligjërisht LDGSH.

Përcaktime të tjera

Neni 39

Aftësia vendimmarrëse

(Kuorimi)

Organet vendimmarrëse të LDGSH kanë aftësi vendimore (kuorum) kur:

1. Ato janë thirrur duke respektuar procedurat dhe afatet e parashikuara në këtë statut.
2. Kanë marrë pjesë në votime mbi 50% e anëtareve me të drejtë vote me përjashtim të rasteve kur në statut parashikohen ndryshe; në rast se nuk ka kuorum drejtuesja e mbledhjes duhet të ndërpresë mbledhjen dhe të njoftojë për rendin e ditës së mbledhjes tjetër.

Në këtë rast, ajo mund të mos marrë parasysh afatet e përcaktuara. Mbledhja tjetër është në cdo rastme aftësi vendimore. Kjo u njoftohet anëtareve.

Nëse vërtetohet mungesa e kuorumit gjatë mbledhjes në castin e votimit, atëherë votimi shtyhet për në mbledhjen tjetër, në përcaktimin e kuorumit llogariten edhe abstenimet edhe votat e pavlefshme.

Neni 40

Shumicat e kërkuara për të marrë vendime

Vendimet quhen të miratuara nëse është e pranishme më shumë se 50% e forumit dhe nëse votat “pro” përbëjnë mbi 50% të votave të vlefshme të pjesëmarrësve në votim, me përjashtim të rasteve kur në statut parashikohet ndryshe.

Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i refuzuar.

Për ndryshime statutore nevojitet shumicë absolute e anëtareve të kuvendit me të drejtë vote.

Neni 41

Llojet e votimit

Votimi bëhet i hapur duke ngritur dorën ose mandatin.

Votimi bëhet i fshehtë në rastet e përcaktuara nga statuti, si dhe kur propozimi për votim të fshehtë mbështetet nga 1/4 e anëtareve me të drejtë vote. Në këtë rast votimi bëhet me fletëvotimi.

Gjatë votimit cdo anëtare ka të drejtën të deklarohet se abstenon.

Neni 42

Dokumentimi i vendimeve

Vendimet e organeve qendrore të LDGSH detyrimisht duhet të dokumentohen, protokollohen dhe arkivohen nga dy persona të caktuara nga sekretarja e përgjithshme.

Neni 43

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e LDGSH

LDGSH financon veprimtarinë e saj me të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë, masa e të cilave përcaktohet nga kryesia qendrore, kontributi financiar i anëtarësisë, kontributi financiar i PDSH dhe burime të tjera të ligjshme. Administrimi i financave të LDGSH bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga kryesia dhe nën kontrollin e një komisioni të përcaktuar prej saj.

Kryesia e LDGSH nuk mund të marrë përsipër detyrime sipas së cilave anëtarët e saj përgjigjen me pasurinë personale.

Neni 44

Dispozita të fundit

Cdo akt i nxjerrë prej organeve të ndryshme të LDGSH nuk duhet të bjerë në kundërshtim me statutin e LDGSH. Cdo akt që del në mbështetje të këtij statuti, si dhe cdo përcaktim i këtij statuti janë në përputhje parimore me Statutin e PDSH. Në rast konflikti përparëi ka statuti i PDSH.

Ky statut mund të ndryshohet me propozim të Këshillit Kombëtar nga shumica absolute e delegateve në Kuvendin Kombëtar.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Ky statut fillon të veprojë me fillimin e seancës vijuese të Kuvendit Kombëtar të LDGSH dhe merr fuqi të plotë pas ratifikimit nga Kryesia e PDSH.